

SHOULD A REFORM BE DONE IN ALBANIA'S ALPHABET? A DUHET BËRË REFORMA NË ABC-NË E SHQIPES?

Asllan HAMITI¹

¹Corresponding author e-mail: asllan_hamiti@yahoo.com

Abstrakt

Alfabeti është tërësia e shkronjave që përdor një gjuhë, të radhitura sipas një rendi të caktuar. Shkrimi fonologjik bazohet në parimin e bashkëlidhjes së një fonemeje me vetëm një shkronjë, por ky është vetëm ideal, sepse në realizim asnjë sistem konvencional i shkrimit nuk është konsekuent dhe plotësisht fonematik. Me fjalë të tjera, dihet se alfabet ideal do të ishte ai që do të kishte vetëm shkronja njëshe e të thjeshta. Një fonemë do të shkruhej gjithnjë dhe në çdo pozicion vetëm me një grafemë. Po alfabet ideal nuk ka. As alfabeti që përdorim sot nuk është ideal. Prandaj, për të përsosur atë, herëpashere janë shfaqur mendime, sugjerime e propozime për ndryshimin e tij. Në këtë kumtesë do të përqipemi të japim mendimin tonë për çështjen e sipërshënuara. Në parim, jemi kundër çdo ndërhyrjeje për ndryshimin e alfabetit të sotëm të shqipes. Në Kongresin e kodifikimit të alfabetit u përcaktua që shqipja të ketë shkrim të përsosur, më të përhapur, më të lehtë e më praktik; pra shkrimin fonetik, më mirë të themi fonologjik. Në këtë lloj shkrimi çdo fonemë jepet me një shkronjë të veçantë (njëshe ose dyshe), kështu që numri i shenjave është i vogël. Kjo zgjidhje e këtitillë e grafisë gjen mbështetje edhe në praktikën e shtypshkrimit të tekstit shqip. Alfabeti i thjeshtë latin është homogjen për nga karakteri i shkronjave, i lehtë për t'u shkruar dhe shumë i volitshëm në shtyp.

Fjalët kyçe: *alfabet, fonemë, shkronjë, reformë, shqiptim dialektor, gjuhë standarde*

The alphabet is the set of letters that a language uses, arranged in a certain order. Phonological writing is based on the principle of associating a phoneme with only one letter, but this is only “ideal”, because in reality no conventional writing system is consistent and completely phonemic. In other words, it is known that the ideal alphabet would be one that would have only single, simple letters. A phoneme would always be written in every position with only one grapheme. Yes, there is no ideal alphabet. Even the alphabet we use today is not ideal. Therefore, to perfect it, thoughts, suggestions and proposals for its change have appeared from time to time. In this statement we will try to give our opinion on the above-mentioned issue. In principle, we are against any intervention to change the current Albanian alphabet. In the Alphabet Codification Congress, it was determined that Albanian should have a perfect, more widespread, easier and more practical script; that is, phonetic writing, better to say phonological. In this type of writing, each phoneme is given with a separate letter (single or double), so the number of signs is small.

This graphic solution also finds support in the practice of printing Albanian text. The simple Latin alphabet is homogeneous in character, easy to write and very convenient to print.

Key words: *alphabet, phoneme, letter, reform, dialect pronunciation, standard language*

Nëse shpikja e alfabetit merret si një ndër zbulimet më të mëdha të njerëzimit, atëherë njësimi i abc-së shqipe mund të vlerësohet si një ndër ngjarjet më të rëndësishme të popullit shqiptar. Njësimi i alfabetit çoi në rrugë të drejtë të gjitha zhvillimet e mëvonshme për ngritjen e vetëdijes dhe formimin e kombit, shuarjen e ndasive krahinore e fetare, hapjen e shkollave në gjuhën amtare, botimin e librave si dhe përhapjen e dijes e të kulturës.

Pajtohem me konstatimin e përgjithshëm se për ne shqiptarët njësimi i alfabetit, njësimi i gjuhës dhe njësimi i kulturës sollën natyrshëm bashkimin e kombit. Unifikimi i alfabeteve që parakusht për bashkimin kombëtar.

Pse u përcaktuam të shtjellojmë këtë çështje: Duhet apo nuk duhet bërë ndryshime në abc-në e shqipes?

Deri më tani shpeshherë jo vetëm studentë, po edhe të tjerë ma kanë bërë këtë pyetje. Madje, herëpashere janë shfaqur mendime se alfabeti shqip ka disa mangësi, me përpjekjet për të dhënë disa sugjerime e propozime për përmirësimin e tij. Të gjitha vërejtjet për të metat e abc-së sotme të shqipes mund të përmbledhen në gjoja 5 vështirësi gjatë shkrimit shqip:

1. në shkrimin e nëntë dyshkronjësive shpenzojmë më shumë kohë, mund, e letër e ngjyrë sesa të kishim vetëm njëshkronjësia;
2. dyshkronjësishat mund të keqlexohen edhe si njëshkronjësia (në pjesët përbërësi të tyre);
3. vështirësia e alfabetizimit automatik të fjalëve nëpërmjet kompjuterit që nisin me dyshkronjësia (meqë kompjuteri i identifikon edhe dyshkronjësishat sipas shkronjës së parë);
4. vështirësi teknike në shkrimin e <ë, ç> për shkak të mungesës së këtyre dy shkronjave në tastierën joshqip të kompjuterit e të telefonit; si dhe
5. <nj>-ja nuk duhet të jetë shkronjë më vete, sepse është shkronjë e panevojshme.

Pra, për të shmangur këto vështirësi do të duhej të mos kishim dyshkronjësia, të mos i kemi shkronjat <ë, ç>-ë dhe <nj>-ë e të shtojmë një shkronjë të re <w> (v-në dyfishe apo dublë vënë) meqë jopak fjalë në formën origjinale në anglisht shkruhen me këtë shkronjë (Word, wikend, sendwic) dhe kjo v-dyfishe duhet të tejbartet edhe në shkrimin shqip të këtyre anglizmave.

Në këtë kumtesë jemi përpjekur të japim mendimin tonë për çështjet e pazgjidhura mirë në alfabetin e shqipes (sipas disave, fatmirësisht të paktë). Në fakt, jemi kundër çdo ndërhyrjeje për ndryshimin e alfabetit të sotëm të shqipes. Pse?

1. Së pari, **për shkak të traditës shekullore të shkrimit të shqipes me alfabet shumë të ngjashëm me abc-në e sotme.**

Dihet se shqipja e shkruar me alfabetin latin të përshtatur për sistemin fonologjik sipas autorësh e krahinash ka një traditë tani më 560-vjeçare (së paku nga Formula e Pagëzimit, 1462 e deri më tani).

Alfabeti i Stambollit (1879) që kishte 36 shkronja për bazë kishte shkronjat latine (me pak shkronja greke e disa shkronja të veçanta). Ai u përhap në Shqipërinë Jugore e të Mesme, sidomos nëpërmjet librave të Naimit, Samiut, Vretos etj., por u përdor edhe në kolonitë shqiptare të Rumanisë e të Bullgarisë. Alfabeti i shoqërisë “Bashkimi” kishte për bazë alfabetin latin të plotësuar me disa dyshkronjësia si edhe i shoqërisë “Agimi” me qendër në Shkodër që po kështu për bazë kishte alfabetin latin të plotësuar me shkronja të alfabetit cirilik e glagolik, por edhe me disa shenja diakritike (shenja plotësuese të vëna mbi ose nën shkronjë).

Nga tre alfabetet (e dhëna në formë tabelore) është fare lehtë të krahasohen e të vërehen ngjashmëritë dhe dallimet midis tyre.

Alfabeti i Agimit (1904)	Alfabeti i Bashkimit (1908)	Alfabeti i Stambollit (1879)	Alfabeti i sotëm i shqipes
a	a	a	a
b	b	b	b
ts	ts	c	c
č	ch	ç	ç
d	h	d	d
d	dh	ð	dh
é	é	ε	e
e	e	e	ë
f	f	f	f
g	g	g	g
g	gh	ġ	gj
h	h	h	h
i	i	i	i
j	j	j	j
k	k	k	k
l	l	l	l
ł	ll	λ	ll
m	m	m	m
n	n	n	n
ń	gn	η	nj
o	o	o	o
p	p	π	p
k	c	q	q
r	r	r	r
ř	rr	ρ	rr
s	s	s	s
š	sh	σ	sh
t	t	t	t
þ	th	θ	th
u	u	u	u
v	v	v	v
dz	z	x	x
dž	xh	χ	xh
y	y	y	y
z	x	z	z
ž	zh	z	zh

Alfabeti i Stambollit ose alfabeti i Sami Frashërit me bazë latine i plotësuar me shkronja greke, respektoi me përpikëri parimin *një tingull = një shkronjë*. Ndonëse nuk u bë kombëtar, u përdor gati për 30 vjet dhe pati përhapje të gjerë sidomos në Shqipërinë e Jugut dhe kolonitë shqiptare të Ballkanit, duke shtypur libra shqip (veprat e Naimit, Samiut etj.). Ky ishte një nga tre alfabetet që u diskutuan në Kongresin e Manastirit.

2. Së dyti, **shqipja standarde ka 36 tinguj themelorë, ose më mirë të themi fonema**, andaj abc-ja e shqipes ka e duhet t'i ketë 36 shkronja (as më shumë e as më pak).

Siç dihet, fonemat ekzistojnë në formën e varianteve kombinatorë, pozicionale, krahinore, individuale e stilistike. Puna e parë dhe shumë e vështirë për alfabetizimin e gjuhës është përcaktimi i inventarit fonologjik të saj. Hartuesit e alfabetit të sotëm të shqipes me punën e tyre dëshmuar se kanë pasur përgatitje të lartë gjuhësore (linguistike). Struktura fonologjike e shqipes standarde me 7 zanore dhe 29 bashkëtingëllore u përcaktua në thelb që me alfabetin e Shoqërisë së Stambollit dhe u ruajt me alfabetin e Manastirit. Ata me 36 shkronjat përcaktuan njëkohësisht edhe inventarin e fonemave zanore e bashkëtingëllore të shqipes standarde (36 fonema), prandaj mund të thuhet se njëkohësisht vunë edhe gurthemelin e gjuhës standarde shqipe.

Me standardizimin e alfabetit u përcaktua edhe baza fonetike e fonologjike e shqipes standarde:

a) Kundërvënia fonologjike e gjatësisë së zanoreve të gegërishtes nuk u normëzua, d.m.th. u pranua vetëm gjatësia fonetike e zanoreve, duke e shënuar çdo zanore vetëm me një shenjë, pavarësisht nga gjatësia e tyre.

b) Fonemat zanore hundore (që përdoren në shumicën e të folmeve geqe, për shkak të kundërvënies kuptimore ose gramatikore të zanoreve gojore me gjegjëset e tyre hundore te disa çifte fjalësh) nuk u normuan si veçori fonologjike e standardit, rrjedhimisht edhe nuk krijuan shkronja të posaçme për to.

c) Mbështetje të drejtë gjuhësore u gjet edhe në dallimin ndërmjet fonemave dhe varianteve kombinatorë e pozicionale të tyre. Për fonema u morën vetëm tingujt themelorë që kanë vlerë fonologjike, gjegjësisht vlerë kuptimore ose gramatikore në ligjërim.

ç) Në Kongresin e Manastirit u përcaktuan edhe shkronjat <rr> e <h> për të shënuar fonemat /rr/, /h/ edhe pse në të folmet e toskërishtes bashkëtingëllojta e parë ishte dhe është zbutur në /r/, ndërsa /h/-ja ka përdorim të kufizuar; ndërkaq në të folmet e gegërishtes këto dy fonema ruhen mirë.

3. Së treti, **në hartimin e alfabetit të shqipes është respektuar parimi themelor i grafisë, që e njëjta fonemë të paraqitet në të gjitha rastet vetëm me një shkronjë të veçantë** (të thjeshtë ose dyshkronjësh), me pak përjashtime.

Puna e parë dhe shumë e vështirë për alfabetizimin e gjuhës është përcaktimi i inventarit fonologjik të saj. Hartuesit e alfabetit të sotëm të shqipes me punën e tyre dëshmuar se kishin përgatitje të lartë gjuhësore (linguistike). Struktura fonologjike e shqipes standarde me 7 zanore dhe 29 bashkëtingëllore u përcaktua në thelb që me alfabetin e Shoqërisë së Stambollit, të Agimit e të Bashkimit dhe u ruajt me alfabetin e Manastirit. Ata me 36 shkronjat përcaktuan njëkohësisht edhe inventarin e fonemave zanore e bashkëtingëllore të shqipes letrare (36 fonema), prandaj mund të thuhet se njëkohësisht vunë edhe gurthemelin e shqipes standarde.

Po të krahasojmë shkrimin e shqipes me disa gjuhë të tjera, abëcëja e shqipes ka disa përparësi. Kështu, anglishtja, frëngjishtja, gjermanishtja, italishtja etj., kur paraqesin alfabetin e tyre, rendisin 26 shkronjat e alfabetit latin, por kombinimet e grafemave për të shënuar fonema të veçanta nuk numërohen si shkronja më vete. Anglishtja, p.sh. si gjuhë mjaft e përpunuar, në shkrim ka disa mangësi, sepse për të shënuar 40 tingujt themelorë të saj përdor mbi 200 kombinime shkronjash.

Në qoftë se verësojmë sistemin grafik të shqipes nga pikëpamja e parimeve të përgjithshme, mund të thuhet se është nga më të thjeshtët (krahasuar me abc-në e gjuhëve të tjera) dhe ka zgjedhur mjaft drejt problemin e shkrimit të gjuhës sonë: 36 fonemat e shqipes shënohen me 36 shkronjat e alfabetit, që përbëhen nga 25 shenja të thjeshta, 9 dyshkronjësha (th, dh, sh, zh, xh, gj, nj, ll, rr) dhe dy shkronja me shenja diakritike (ë, ç). Nga kjo pikëpamje, në vija të përgjithshme, është respektuar parimi themelor i grafisë, që e njëjta fonemë të paraqitet në të gjitha rastet vetëm me një shkronjë të veçantë (të thjeshtë ose dyshkronjësh).

Përdorimi i shkronjave dyshe ka të mirat e veta, ngase me një numër më të vogël shenjash, përkatësisht me 27 shenja të thjeshta (kuptohet dhe me 9 çiftet e tyre) paraqiten 36 fonemat e gjuhës sonë. Por, kjo ka edhe të meta, sepse: 1) dyshkronjëshat zgjatin tekstin e shkruar; 2) krijojnë mundësi që disa çifte shkronjash të lexohen në dy mënyra, d.m.th. si digrafe dhe si shkronja të veçanta që vijnë njëra pas tjetrës, p.sh. *lagje, lagja* ose *lag'je, lag'ja*; *Mithat* ose *Mit'hat*; *meshollë* ose *mes'hollë, gazedhës* ose *gaz'hedhës* etj. Në mënjanimin e leximin dyfarësh, në shumë fjalë vënia e apostrofit mund të jetë zgjidhje (*Mit'hat*; *mes'hollë, gaz'hedhës* etj.).

Në sistemin grafik të gjuhës shqipe grafemat janë të njëvlerëshme, sepse tregojnë gjithnjë të njëjtën fonemë. Shkronja <i> mund të thuhet se është e vetmja me dy vlera në sistemin grafik të shqipes: me të përgjithësisht jepet fonema /i/, por në raste të caktuara edhe fonema /j/. Jo vetëm në rastet *djegje, zënie, pedagogia* etj. (ku shkruhet <i>, ndërsa lexohet ëj]), po edhe në një varg fjalësh të huaja që shkruhen me grupet <ia, ie, io, iu> (si *variant, malarie, aksion, stadium* etj.) ajo shqiptohet si ëj]. Në një numër të vogël fjalësh, kryesisht të burimit latin, <u>-ja e ka vlerën e një gjysmëzanoreje (të ngjashme me shqiptimin e ëv]-së, respektivisht v-së dyfishe ëw] në anglishte), si *kolokuium, akuarium, kuadër, kuarc, kuotë* etj., duke formuar diftong me zanoren tjetër fqinje. Edhe fjalët e tilla ku shkruhet <i> e lexohet /j/, apo shkruhet <u> e lexohen /v/ nuk paraqesin ndonjë vështirësi.

4. Arsyeja e katërt: **përdorimi i shkronjave dyshe ka të mirat e veta**, ngase me një numër më të vogël shenjash, përkatësisht me 27 shenja të thjeshta (kuptohet dhe me 9 çiftet e tyre) paraqiten 36 fonemat e gjuhës sonë. Për t'u ruajtur shqiptimi i veçuar i pjesëve përbërëse të dyshkronjëshave dhe për t'iu shmangur leximit të gabueshëm si njëshkronjësh, propozohen që shkronjat e veçanta të ndahen me apostrof, si: *i herëpas'hershëm, mes'hollë, mos'hapje, mos'hyrje, dis'harmoni; shtat'hedhur; brez'humbur, gaz'hedhëse; Bet'hoven, Et'hem, Mit'hat* etj.

Për t'iu përmbajtur me përpikëri parimit që një fonemë të shkruhet vetëm me një shkronjë, ka mendime se mund të përkryhet dhe ekonomizohet sistemi grafik i gjuhës sonë, sepse sistemi grafik që e kemi në përdorim ka mangësi për shkak të përdorimit të digrameve, ngaqë nuk përfillet kërkesa e ligjit të ekonomizimit gjuhësor. Dihet se njeriu gjithmonë përpiket që me sa më pak mund të arrijë efekte më të mëdha në dhënien e informacioneve. Ky ligj i ekonomizimit në të folur, parimisht duhet të përcillet edhe në transkriptimin sa më ekonomik të ligjërit njerëzor.

Nëntë dyshkronjëshat janë numerikisht një e katërta e alfabetit të shqipes. Në dukje kjo është një ngarkesë e madhe. Por sipas studimeve statistikore të nëntë shkronjat zënë 6-7% të tërësisë së shkronjave në një tekst të lidhur. Me fjalë të tjera, në çdo njëqind shkronja të një teksti, vetëm 6-7 shenja janë dyshkronjështa. Dendurinë më të madhe ndër këto e ka <sh>-ja me rreth 2.5%, pastaj vjen <dh>-ja me diçka më shumë se 1%, kurse të gjitha të tjerat e kanë dendurinë më pak se 1% (<nj>-ja me 0.67%, <gj>-ja 0.65%, <rr>-ja 0.50%, <ll>-ja me 0.47%, <th>-ja me afër 0.47%, <xh>-ja dhe <zh>-ja me rreth 0.06%. Nga kjo rrethanë sasiore shihet se pesha specifike e dyshkronjështave në të shkruarit e gjuhës shqipe është e vogël dhe praktikisht ato nuk përbëjnë ndonjë mbingarkesë.

Në shkurtesa (akronime) kur kemi dyshkronjonjështa, atëherë te to shkronja e parë të shkruhet e madhe, ndërsa shkronja e dytë, që është pjesë përbërëse e dyshkronjështit, të shkruhet me shkronjë të vogël, sipas tipit: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë – IGjL, Shtetet e Bashkuara të Amerikës - ShBA, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës – AShAK; Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - ITShKSh, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës – AZGj etj.

Me këtë do të sigurohet leximi i saktë i shkronjave dyshe për një fonemë të vetme, e jo si dy shkronja të veçanta për dy fonema të ndryshme (Sh e jo S-H, Th e jo T-H...). Për arsye pamore a estetike në tituj, tabela, reklama etj. edhe shkronja e dytë e dyshkronjështit të shkruhet e madhe, pra të gjitha shkronjat (një e dyshkronjëshat) të shkruhen të mëdha. Këtë praktikë përdorimi e gjejmë edhe në shumë shkrime, por e zbatoj që moti edhe unë. Ankesat lidhur me vështirësitë që kanë në shkrimin e <ë, ç> janë të pabaza, meqë tastierën shqip shumë lehtë mund ta instalojmë në kompjuter e telefon.

Duhet apo nuk duhet <nj>-ja të jetë shkronjë më vete?

Digrafi <nj> është dhe duhet të jetë shkronjë më vete, sepse me të shënohet fonema /nj/ e shqipes. Tingulli e fonema /nj/ nuk është bashkim shqiptimor i dy tingujve të veçantë [n] + [j], por shqiptohet si një tingull i vetëm dhe në sistemin fonologjik të shqipes standarde funksionon si fonemë më vete.

Si shkronjë më vete e kanë edhe shumë gjuhë të tjera indoevropiane. P.sh. në maqedonishte e në serbishte (në alfabetin cirilik) fonema /nj/ shënohet me shkronjën <њ> (диња, полиња, дење ‘dinja, polinja, denje’).

As v-ja dyfishe nuk duhet të bëhet pjesë e abc-së shqipe. Huazimet duhet të përshtaten me sistemin grafik, fonetik, morfologjik e sintaksor të shqipes.

Mund të përfundojmë se **nuk duhet bërë asnjë ndryshim në abc-në e shqipes**. Lëkundja e themeleve të saj nuk i sjell asnjë dobi shqipes. Fajet nuk i ka alfabeti, fajet i kemi vetë që nuk duam e nuk dimë ta përdorim si duhet. Përdoruesit e mirë, me këto shkronja po arrijnë të krijojnë vlera kulmore letrare, artistike e shkencore. Po ky alfabet parapriu njësimin e kombit dhe shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, përcaktoi bazën fonologjike të shqipes standarde, duke vënë gurthemelin e saj; dobësoi përçarjen krahinore dhe politikën asimiluese, zgjoi dhe fuqizoi vetëdijen kombëtare, dëshmoi se jemi një komb, që kemi një histori, një gjuhë, një alfabet, një drejtshkrim.

Dy fazat e para të planifikimit gjuhësor: 1) alfabetizimi dhe 2) standardizimi i shqipes janë kryer me shumë sukses. Tani gjendemi në stadin e modernizimit të gjuhës shqipe, që nuk përfundon kurrë. Disa përmirësime e përditësime duhet e mund të bëhen në rregullat e drejtshkrimit të shqipes, por jo në abc-në e saj.

Në kohën e sotme, në kohën e modernizimit të shqipes, duhet bërë përpjekje për ta bërë shqipen të aftë për të përmbushur nevojat e shumëllojshme të shoqërisë sonë dhe për të konkuruar me sukses me gjuhët më të zhvilluara të botës. Puna jonë kryesore duhet të jetë: **pasurimi leksikor i shqipes dhe pastrimi i saj nga elementet e huaja.**

Literatura e konsultuar:

- [1]. AShSh, *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe* (2007), vëllimi I, Napoli; vëllimi II (2008), i. Napoli.
- [2]. Badallaj, Imri (1977), *Nazalizimi i zanoreve si veçori qenësore e dialektit gegë*, ZA, nr. 10, i. Eianina (Cs).
- [3]. Badallaj, Imri (2001), *E folmja e Hasit*, Prishtinë.
- [4]. Demiraj, Shaban – Prifti, Kristaq (2004), *Kongresi i Manastirit*, AShSh, Instituti i Historisë, Tiranë.
- [5]. Grup autorësh (1983), *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe I, Fonetika* (maket), Tiranë.
- [6]. Hamiti, Asllan (2007), *Alfabeti i gjuhës shqipe*, Vjetari i Fakultetit të Filologjisë “Bllazhe Koneski”, libri 33, Shkup.
- [7]. Hamiti, Asllan (2011), *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup.
- [8]. Hamiti, Asllan – Qamili, Ajten (2014), *Dialektologjia e gjuhës shqipe*, Shkup.
- [9]. Lafe, Emil (1998, 1999), *Alfabeti i Kongresit të Manastirit i vështruar nga koha e sotme*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup; Studime filologjike 1-2, Tiranë.
- [10]. Memushaj, Rami (2002), *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë.
- [11]. Nushi, dr. Pajazit (1988), *Sistemi i grafisë së tingujve të shqipes dhe vetitë perceptive e përmasat e lexueshmërisë së shkronjave të alfabetit të gjuhës shqipe*, Prishtinë.
- [12]. *Opća enciklopedija 5* (1979), Zagreb.
- [13]. Savicka, Irena - Spasov, Ludmill (1997), *Fonologjia na sovremeniot makedonski standarden jazik*, Skopje.
- [14]. Silić, dr. Josip (1979), *Opća enciklopedija 5*, Zagreb.
- [15]. Rosandić, dr. Dragutin (1977), *Osnove fonetike i fonologije hrvatskog književnog jezika*, Zagreb, 1977.